

**RELACION**  
**PËR**  
**PROJEKTVENDIMIN**  
**PËR**  
**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË**  
**KOMBËTARE TË EKONOMISË SË MBETJEVE**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN**  
**TË ARRIHEN**

Ky projektvendim synon krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve (AKEM), si organi shtetëror i specializuar në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve, në përputhje me funksionet e përcaktuara në këtë vendim. Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve parashikohet të mbështesë teknikisht politikat e ministrisë përgjegjëse për mjedisin në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve, me qëllim kalimin drejt ekonomisë qarkulluese (koncepti kryesor i të cilës është minimizimi i mbetjeve përmes reduktimit, ripërdorimit, riciklimit), edukimin mjedisor, promovimin dhe nxitjen e zbatimit të hierarkisë së mbetjeve për zhvillimin gradual të grumbullimit përmes ndarjes në burim dhe riciklimit në shkallë të gjerë, bashkëpunimin me NJQV-të, institucionet publike dhe partnerët ndërkombëtarë për kalimin drejt ekonomisë qarkulluese, në përputhje me legjislacionin dhe politikat e përcaktuara në strategjitë sektoriale dhe legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Përgjegjësia e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve është në përputhje me përgjegjësitë e ministrisë përgjegjëse për mjedisin.

Ky projektvendim vjen si propozim i ministrisë përgjegjëse për mjedisin, si rezultat edhe i heqjes së fushës së përgjegjësisë së infrastrukturës së mbetjeve të ngurta, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, nëpërmjet Vendimit Nr. 111, datë 2.3.2022 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë” (i ndryshuar me VKM nr. 519, datë 29.7.2022). Si rrjedhojë, AKUM-i nuk ushtron më funksionet e përcaktuara në

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”.

VKM nr. 431, datë 11.7.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve” që lidhen me komponentë të caktuar të fushës së menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane.

Nisur nga fusha e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, të përcaktuar, në Vendimin Nr. 112, datë 2.3.2022 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”, pika 3, shkronja “a” e këtij vendimi, ku parashikohet se: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e ushtron veprimtarinë e saj, në përputhje me legjislacionin përkatës, në këto fusha *përgjegjësie shtetërore*: a) sektori i mjedisit, përfshirë politikën, standardet e trajtimit të mbetjeve, është propozuar që fusha e koordinimit dhe monitorimit në bashkëpunim me Njësitë e Qeverisjes Vendore, institucionet e administratës publike dhe partnerët ndërkombëtarë në menaxhimin e integruar të mbetjeve, duke përfshirë edukimin mjedisor, t’i kalojë një agjencie të re të specializuar në fushën e menaxhimit të mbetjeve, si strukturë në varësi të ministrisë përgjegjëse për mjedisin.

AKEM do të jetë institucioni përgjegjës për monitorimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve, me qëllim kalimin drejt ekonomisë qarkulluese, edukimin mjedisor, promovimin dhe nxitjen e zbatimit të hierarkisë së mbetjeve për zhvillimin gradual të grumbullimit përmes ndarjes në burim dhe riciklimit në shkallë të gjerë, bashkëpunimin me NJQV, institucionet publike dhe partnerët ndërkombëtarë për monitorimin e implementimit të standardeve për menaxhimin efikas të integruar të mbetjeve, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në këtë vendim dhe dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.

Gjithashtu, Agjencia do të monitorojë planifikimin e nevojave për investime për ndërtimin/rehabilitimin/zgjerimin për sa i përket menaxhimit të integruar të mbetjeve, bazuar në programet e qeverisë dhe në masterplanet kombëtare sektoriale.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”.

Ky projektvendim nuk është planifikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve të vitit 2024 për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Projektvendimi synon krijimin e një institucioni të ri në fushën e monitorimit të menaxhimit të mbetjeve urbane, ndjekjes së projekteve për infrastrukturën e menaxhimit të mbetjeve dhe koordinimit së bashku me NJQV-të, institucionet publike dhe partnerët ndërkombëtarë të planifikimit të nevojave për investim për trajtimin e mbetjeve bashkiake që do të ndikojë në zbatimin më efektiv të politikave që lidhen me menaxhimin e integruar të mbetjeve, duke qenë një institucion në varësi të ministrisë përgjegjëse për mjedisin, si institucion i politikbërjes në këtë fushë. Gjithashtu, kjo agjenci nëpërmjet autoritetit të saj ligjor e teknik, do të ketë rol koordinues dhe monitorues të aktiviteteve sektoriale që lidhen me krijimin dhe monitorimin e sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve, në nivel rajonal dhe vendor, në bashkëpunim me të gjitha institucionet e vendit, në nivel qendror e vendor. AKEM-i mbështet teknikisht zbatimin e politikave dhe strategjive në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve, në përputhje me objektivat dhe drejtimet strategjike të vendosura në dokumentin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2020-2035.

Theksojmë se iniciativa për propozimin e këtij vendimi vjen edhe si pasojë e heqjes së fushës së përgjegjësisë që lidhet me mbetjet urbane nga misioni dhe funksionimi i MIE-s dhe nga Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve, si institucion në varësi institucionale pranë MIE-s. Në këtë projektvendim është konceptuar që në përbërje të AKEM të ketë kapacitete teknike dhe menaxheriale të specializuar në fushën e monitorimit dhe koordinimit të sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në këtë vendim dhe dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, për trajtimin e problematikave të mbetjeve.

### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”.

Projektvendimi i propozuar është në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr. 90, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Ky projektvendim nuk përfron me Acquis të BE-së.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Nëpërmjet këtij projektvendimi janë parashikuar kërkesat për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve (AKEM), si organi shtetëror i specializuar në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve, në përputhje me funksionet e përcaktuara në këtë vendim.

Sqarojmë se ky projektvendim është ristrukturuar sipas sugjerimeve të DAP-it dhe institucioneve të linjës, gjatë bashkërendimit të projektaktit. Konkretisht:

Projektvendimi ka përmbajtjen si më poshtë vijon:

**Në kreun I**, janë parashikuar Dispozitat e Përgjithshme, që lidhen me dispozitat mbi krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të AKEM, financimin dhe burimet e financimit si dhe misioni i kësaj agjencie.

**Në kreun II** janë parashikuar përgjegjësitë funksionale të AKEM-it, që lidhen me rolin koordinues dhe organizues të punës për edukimin mjedisor dhe nxitjen e zbatimit të hierarkisë së mbetjeve.

**Në kreun III**, janë parashikuar rregulla mbi organizimin dhe funksionimin e AKEM-it, emërimin, shkarkimin, lirimin e Drejtorit të Përgjithshëm si dhe përcaktimin e formës së marrëdhënieve të punës të punonjësve të AKEM-it. Gjithashtu ky kre parashikon edhe detyrat e kësaj agjencie, në zbatim të misionit, fushave të përgjegjësisë dhe përgjegjësiwe funksionale të saj; miratimin e strukturës dhe organikës me urdhër të Kryeministrit si dhe miratimin e rregullores së brendshme të punës nga ministri përgjegjës për mjedisin. Së fundmi, në këtë kre janë parashikuar edhe stema, vula dhe logo e agjencisë.

**Në kreun IV**, “Dispozita kalimtare dhe të fundit”, janë parashikuar përballimi i efekteve financiare dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”.

## V. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e vendimit ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve.

### PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti i propozuar është hartuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe iu përcoll për mendim nëpërmjet sistemit e-akte Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë dhe Departamentit të Administratës Publike, të cilat janë shprehur si vijon:

**Departamenti i Administratës Publike**, shprehet parimisht dakord, ku nga pikëpamja teknike, në komentin sipas 1, ka sugjeruar organizimin e projektvendimit në krerë, sugjerim i cili është marrë në konsideratë dhe është reflektuar, duke organizuar projektvendimin në 4 krerë, që përmbajnë secila çështjet kryesore, sipas sugjerimit të DAP.

Sa i përket komentit sipas pikës 2, në lidhje me dispozitat konkrete të çdo kreu, bëjmë me dije se:

\*Në Kreun I, “Dispozita të Përgjithshme”, është sugjeruar që të përfshihet përmbajtja e pikave 1, 2, 3 dhe 10, të riformuluara sipas sugjerimit të DAP-it, ku lidhur me këtë sugjerim sqarojmë se:

Pikat 1 dhe 2 dhe 3 janë marrë në konsideratë. Pika 3 është riformuluar dhe përshtatur, sipas sugjerimeve të DAP, duke mbajtur në konsideratë edhe parashikimet e këtij projektvendimi, në funksion të qëllimit të krijimit të AKEM-it dhe në përputhje me fushën e përgjegjësisë së MTM-së.

Gjithashtu, lidhur me sugjerimin për riformulimin e pikës 4, vlerësojmë se është ezauruar, pasi kjo pikë është riformuluar në përmbajtjen dhe formën e projektvendimit, referuar sugjerimeve të DAP dhe krijon përsëritje.

\* Kreun II, është riorganizuar sipas sugjerimit të DAP-it, ku janë përfshirë

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”.

parashikimet në mënyrë të përmbledhur mbi Përgjegjësitë funksionale të AKEM, si vijon:

Shkronja a) e propozuar është vlerësuar të hiqet si pikë nga teksti i projektvendimit, ndërsa shkronjat b) dhe c) janë marrë në konsideratë sipas sugjerimit të DAP-it.

\*Sa i përket sugjerimit për shkronjën c), sqarojmë se është riformuluar kriteri duke mbajtur në konsideratë se marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e punës dhe është parashikuar si kriter i përgjithshëm zotërimi i diplomës të ciklit të dytë të studimeve, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë.

\* Për sugjerimin sipas shkronjës d), që lidhet me riorganizimin e kreut IV, sqarojmë se të gjitha dispozitat për kreun III, sqarojmë se janë riformuluar sipas sugjerimit.

\*Sa lidhet me komentin sipas pikës 3, për dhënien e shpjegimit në relacion për formën e marrëdhënieve të punës të punonjësve të AKEM, sqarojmë se:

AKEM është një strukturë që ngrihet për herë të parë dhe vjen si rrjedhojë e ndryshimit të fushës së përgjegjësisë së ish Agjencisë Kombëtare të Ujësjiellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, institucion i cili është në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), çka sjell edhe kalimin e komponentit të mbetjeve nga fusha e përgjegjësisë së AKUM, në fushën e përgjegjësisë së MTM-së. Marrëdhëniet e punës së stafit të AKUM kanë funksionuar sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë dhe është vlerësuar që edhe marrëdhëniet e punës së strukturës së AKEM të vijojnë në të njëjtën mënyrë.

**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë** është shprehur dakord me komentin si më poshtë:

Në pikën 11 të projektvendimit, të shtohet si kompetencë e Agjencisë një pikë e re, e cila është reflektuar në projektvendim në gërmën ç, pika 7, Kreu III.

**Ministria e Financës** është shprehur parimisht dakord për sa kohë që efektet financiare dhe ato në numrin e punonjësve janë brenda buxhetit të miratuar për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për vitin 2024.

**Ministria e Drejtësisë** është shprehur me sugjerimet si vijon:

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”.

1. Sa i përket ligjshmërisë së formës e përmbajtjes, Neni 10 i ligjit nr. 9000/2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", duhet të hiqet nga baza ligjore e projektvendimit pasi konsiderohet i panevojshëm. Në autorizimin ligjor të tij duhet të qëndrojë vetëm neni 6 i ligjit nr. 90/2012. Lidhur me këtë sugjerim sqarojmë se u mor në konsideratë dhe u hoq nga baza ligjore e projektvendimit, pikë e cila është reflektuar në projektvendim.

Sa i përket sugjerimit për riformulimin e kompetencave të AKEM-it si strukturë varësie e MTM-së, pasi janë shumë të përgjithshme dhe nuk lidhen me natyrën e kompetencave që duhet të ketë një institucion varësie që ngrihet dhe funksionon në përputhje me nenin 6, të ligjit nr. 90/2012, sqarojmë se detyrat funksionale të agjencisë janë riformuluar në tërësi, duke reflektuar sugjerimet e DAP-it, i cili ka riformuluar në tërësi përmbajtjen e projektvendimit në përputhje me funksionet që parashikohen në ligjin nr. 90/2012.

Gjithashtu, lidhur me komentën që në relacionin shoqëruar të projektvendimit, të jepen shpjegime në lidhje me kalimin nga ekonomia lineare drejt ekonomisë qarkulluese, sqarojmë se kalimi nga ekonomia lineare drejt ekonomisë qarkulluese, është një prioritet i parashikuar në dokumentin e politikave strategjike për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020-2035, dhe nuk ka lidhje me funksionimin e sistemit të incenerimit të mbetjeve, pasi vetë sistemi i incenerimit është pjesë e hierarkisë së mbetjeve, si mundësi e fundit kur janë ezauruar proceset e tjera si parandalimi, ripërdorimi dhe riciklimi dhe nuk përjashton sistemet e tjera të menaxhimit të mbetjeve. Bëjmë me dije se misioni dhe përgjegjësitë e AKEM-it janë ripunuar duke mbajtur në konsideratë komentet e DAP-it.

Sa i përket komentit 1.3 mbi përfshirjen e administratës së AKEM-it në shërbimin civil, sqarimet janë dhënë tek reflektimi i komenteve të DAP-it dhe në parim është dakordësuar me DAP-in mbi formën e marrëdhënieve të punës, për shkak se ky institucion krijohet si rrjedhojë e ndryshimit të fushës së përgjegjësisë së AKUM-it, i cili ka funksionuar dhe funksionon sipas parashikimeve të Kodit të Punës.

Projektvendimi iu dërgua për shqyrtim dhe miratim Këshillit të Ministrave, dhe nëpërmjet sistemit elektronik *e-akte* është kthyer me arsyetimin se praktika e projektvendimit ka nevojë për ribashkërendim me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Departamentin e Administratës Publike (DAP), si dhe projektvendimi duhet të ishte dërguar për mendim në

Këshillin Konsultativ Qeverisje Qendrore - Vetëqeverisje Vendore, pasi në pikën 3, të Kreut I, të projektvendimit, parashikohet:

3. *Agjencia ka si mision të sigurojë koordinimin, monitorimin dhe bashkëpunimin me njësitë e qeverisjes vendore (NJQV). Gjithashtu, u sugjerua edhe rishikimi i pikës 3, të Kreut I, të projektvendimit, pasi është dhënë 2 herë misioni i Agjencisë.*

Bazuar në sa më sipër, projektvendimi i ripunuar do të përcillet për bashkërendim tek Ministria e Drejtësisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe tek Departamenti i Administratës Publike, si dhe do të përcillet për mendim tek Këshilli Konsultativ Qeverisje Qendrore - Vetëqeverisje Vendore.

## **VI. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Ky projektvendim parashikohet të sjellë pasoja financiare për buxhetin e shtetit që lidhen me shpenzimet operative për ngritjen dhe funksionimin e Agjencisë dhe pagat e punonjësve.

Konkretisht përllogaritja e efekteve financiare për strukturën e AKEM, me 28 punonjës, parashikohet sipas zërave buxhetorë të mëposhtëm:

Për llogarinë ekonomike 600 (Paga) efekti financiar parashikohet në vlerën 41.000.000 lekë/vit.

Për llogarinë ekonomike 601 (Sigurime shoqërore) efekti financiar parashikohet në vlerën 6.850.000 lekë/vit.

Ky efekt financiar i përllogaritur është planifikuar në PBA 2024-2026.



**MINISTRI**

**Mirela KUMBARO FURXHI**